Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë joftimprurëse kosovare që punon për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si parakusht për shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabilitet rajonal.

ATRC-ja punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativave qytetare, administratës publike, subjekteve politike dhe mediave pa dallim feje, përkatësie politike, etnie, moshe, gjinie, aftësie dhe orientimi seksual.

ATRC-ja përbush qëllimet e veta përmes avokimit, trajnimit, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit në Kosovë dhe jashtë saj.

Për ATRC-në

Që prej themelimit në vitin 2001, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) në Prishtinë ka ndihmuar një numër të madh të organizatave joqeveritare (OJQ-ve) në Kosovë për të profesionalizuar punën e tyre, artikuluar kërkosat e tyre dhe avokuar te strukturat qeveritare për çështjet që ndikojnë shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes këshillimit afat-gjatë, trajnimit, ndarjes së granteve, avokimit, shkëmbimit të informatave dhe asistencës teknike. ATRC është qendër e trajnimeve, menaxhimit të granteve, resurseve dhe informimit për OJQ-të. Programet e ATRC-së janë të përpiluara për të plotësuar nevojat e OJQ-ve.

Shërbimet e ATRC-së përfshijnë menaxhim grantesh; trajnime dhe konsulenca bazike dhe të avancuara në fusha kyçë të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avokim dhe shtim fondesh; resurse elektronike informative përmes faqes së vet të internetit; marketing dhe komunikim; diskutime dhe tryeza publike, ndërtim koalicionesh, lehtësim të partneritetev dhe bashkëpunimeve ndërsektoriale.

Për të përbushur misionin e vet, ATRC po ashtu bashkëpunon me OJQ-të e tjera në tërë Kosovën në fushata të avokimit, të cilat përqendrohen në zhvillimin demokratik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe udhëheq me qendrën e burimeve dhe bibliotekën me botime që kanë të bëjnë me çështjet sociale, politike dhe ekonomike në Kosovë dhe Ballkan.

Gjatë tri viteve e gjysmë të para të saj, ATRC-ja ka qenë partnere implementuese e Projektit të OJQ-ve Kosovare për Avokim të përkrahur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Gjatë kësaj kohe, ATRC ka bashkëpunuar ngushtë me Institutin për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI), i cili ka drejtuar projektin, si dhe me Fondacionin për Iniciativë Demokratike, organizatë vendore kjo për ndarje grantesh. Gjatë këtij projekti, ATRC ka ofruar trajnime, ngritje kapacitetesh, përkrahje të aktivitetave avokuese, dhe mundësi shkëmbimi informash për OJQ-të në tërë Kosovën dhe jashtë saj.

Në mes të vitit 2005, ATRC-ja është bërë partnere vendore e Bordit për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX) për të përkrahur zhvillimin e OJQ-ve kosovare në kuadër të Programit trejeçar për Shoqëri Civile (KCSP) të financuar nga USAID. ATRC që nga kjo kohë ka pësuar ndryshime në personel, udhëheqje, bord dhe programe. Ne në ATRC mendojnë se këto ndryshime na kanë mundësuar të përmirësojmë kualitetin e shërbimeve tona në forcimin e autonomisë, efikasitetin, qëndrueshmérinë dhe ndikimin e shoqërisë civile në Kosovë si faktorë ndryshimi në shoqëri dhe përgjegjës për qeverisje demokratike. Kemi përfshirë trajnerë ekspertë të kualifikuar në ekipin tonë, gjë që ka përmirësuar kualitetin e trajnimeve në dispozicion për OJQ-të në Kosovë. Anëtarë të rinj të bordit janë angazhuar në dhënien e kontributit të tyre dhe mbikëqyrjen e veprimitarive të organizatës. Departamenti i jonë për marrëdhëniet me publikun ka punuar për t'i dhënë ATRC-së një pamje të re, sikurse edhe pasur qasje më të madhe tek publiku përmes ndryshimeve në faqen tonë të internetit dhe në buletin.

ATRC ka zgjeruar portofolin e shërbimeve të veta me administrimin e granteve të Programit Kosovar për Shoqëri Civile të IREX-it. Në korrik 2006, ATRC ka formalizuar një marrëveshje me IREX-in për të ndarë dhe administruar një portofol vjetor të granteve për organizatat kosovare të shoqërisë civile në kuadër të KCSP programit të financuar nga USAID, i cili përfshinë Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim, Grantet për Përkrahje në Nivel Lokal, dhe Grantet për Fushatë Avokimi në Nivel Qendror. Që nga muaji korrik 2006, ATRC është partnere implementuese e UNHCR Projektit për Monitorim të të Kthyerëve në Aeroportin e Prishtinës për të regjistruar të kthyerit me dhunë dhe vullnetar nga shtetet perëndimore.

Përkrahësit

Në mënyrë që të realizoj programe dhe aktivitete të ndryshme, ATRC varet nga burimet financiare dhe njerëzore të ofruara nga përkrahësit e saj.

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

Bordi për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX)

Fondi Ballkanik për Demokraci (BTD)

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES)

IPKO Institut (IPKO)

Partnerët

Numri i organizatave dhe institucioneve të cilat ATRC i konsideron partnerë është rritur. Në vitin 2006, ATRC ka krijuar partneritete të reja me organizata të ndryshme kosovare dhe ndërkontinentale, institucionale dhe organe qeverisëse në përpjekje për të afruar qytetarët me vendim-marrësit. Të gjithë partnerët kanë siguruar përkrahje morale, shkëmbjen ekspertizën dhe bashkëpunuar ngushtë me ATRC-në në projekte dhe aktivitete të ndryshme.

Bordi për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare - IREX

(Programi Kosovar për Shoqëri Civile dhe Programi Kosovar për Asistencë Mediave)

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)

Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK)

Komisioni i Pavarur për Media (IMC)

Instituti Riinvest

Qendra e Trajnimive dhe Hulumtimeve Gjinore

Ministria e Pushtetit Lokal

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet - Çohu

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR)

Zyra e Presidentit të Kosovës

Instituti për Planifikim Hapësinor

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

Asociacioni Njerëzit në Rrezik (Slovakia)

Fondacioni për Iniciativë Demokratike (FDI)

Habitati i OKB-së

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrisë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Agjencia Kosovare për Antikorrupsion

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën e Organizatave Jo për Përfitim (ICNL)

OJQ Epoka e Re (Deçan)

Rrjeti Rinor i Kosovës (RrRK)

Fondi Ballkanik për Demokraci (BTD)

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme

Qendra Rajonale Mjedisore (REC)

Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës

Shoqata e Pensionistëve të Kosovës

Qendra e Resurseve për OJQ, Prizren

OJQ "Mingos", Mitrovicë

OJQ Forum, Gjakovë

Për këtë raport

Raporti vjetor 2006 i ATRC-së u ofron partnerëve, përkrahësve dhe qytetarëve pasqyrë të punës dhe aktiviteteve tona. Raporti përshkruan aktivitetet prej janarit deri në dhjetor 2006 në kuadër të katër programeve tona kryesore: Trajnim konsulencë & ngritje kapacitesh, Informim, Menaxhim grantesh, dhe Avokim. Të dhënët për harxhimet financiare të ATRC-së në vitin 2006 dhe kontakt informatat gjenden në fund të këtij raporti. Informata shtesë për ATRC-së mund të gjeni në: www.advocacy-center.org



Programi për trajnim, konsulencë & ngritje kapacitetesh

Programi i ATRC-së për Trajnim, Konsulencë dhe Ngritje Kapacitetesh ka për qëllim tu siguroj përfaqësuesve të organizatave joqeveritare (OJQ-ve) mjetet dhe ekspertizën që u nevojiten për të ndikuar në ndryshime në komunitetet e tyre. Gjatë pesë viteve të fundit, ky program ka ofruar trajnime në menaxhimin organizativ, avokim, punën me media, planifikimin strategjik, funksionimin e qeverisë dhe tema të tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me OJQ-të e që i kontribuojnë zhvillimit të potencialit të tyre të plotë dhe u mundësojnë realizimin e qëllimeve strategjike në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Pasi që organizatat janë ballafaquar me sfida të reja, ATRC ka modeluar trajnime më të avancuara posaçërisht për ti përbushur nevojat e tyre.

Në vitin 2006, trajnerët e ATRC-së kanë mbajtur 21 trajnime bazike dhe të avancuara në fusha kyçë të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avokim, dhe shtim fondesh, në të cilat kanë marrë pjesë më shumë se 525 persona të gjashtë nacionaliteteve.

Trajnimet dhe konsulencat ndahen në tri kategori: workshope, konsulenza individuale dhe trajnime sipas kërkesës. Trajnimet janë fokusuar në temat:

Hyrje në avokim dhe ndërtim koalicionesh

Në shkurt dhe në tetor, ATRC-ja ka organizuar trajnim dy-ditor të titulluar „Hyrje në avokim dhe ndërtim koalicionesh”. Trajnimi është përqendruar në zhvillimin e shkathtësive avokuese dhe ndërtim koalicionesh për të kryer punë efektive avokuese. Trajnimi ishte mundësi për OJQ-të kosovare që ta kuptojnë procesin avokues dhe se si ky proces ndikon në politikat publike, ti identifikojnë çështjet për të avokuar, të përcaktojnë objektiva të qarta avokuese, të zgjedhin strategji efektive avokuese, dhe të ndërtojnë rrjete dhe koalicionë për të pasur ndikim më të madh avokimi.

Menaxhimi i projektit

Në mars dhe në shtator, ATRC-ja ka trajnuar përfaqësuesit e OJQ-ve se si të menaxhohet cikli i projektit. Trajnimi tre-ditor ka mbuluar konceptet kyçë në menaxhimin e projektit përfshirë zhvillimin e idesë, analizën e problemit, shkrimin e projekt propozimit, zbatimin e projektit, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin. Pjesëmarrësit janë trajnuar mbi metodologjitetë dhe mjetet e nevojshme për menaxhim të suksesshëm të projekteve.

Menaxhimi i OJQ-së

Në kuadër të serisë së trajnimeve për vitin 2006, ATRC-ja ka mbajtur në prill, tator dhe nëntor trajnim tri-ditor, i cili përqendrohet në parimet e menaxhimit dhe zhvillimit organizativ të OJQ-ve. Pjesëmarrësit rishikuan misionet e tyre, zhvilluan aftësitë për planifikim strategjik, dhe u njoftuan me principet e zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve përbrenda OJQ-së.



Sigurimi i fondeve dhe marrëdhëniet me donatorë

Në prill, përfaqësues të OJQ-ve vendore janë trajnuar mbi strategjitë dhe teknikat e ngritjes së suksesshme të fondeve dhe marrëdhëniet me donatorë. Trajnimi i organizuar dhe mbajtur nga trajnerët e ATRC-së u ka ndihmuar pjesëmarrësve të mësojnë për aktivitete të ndryshme për shtim-fondesh dhe krijimit të marrëdhënieve efektive me donatorë, si dhe zhvillimin e planeve për ngritje fondesh bazuar në praktikat më të mira. Pjesëmarrësve u janë shpalosur edhe teknikat e komunikimit për ngritje institucionale fondesh dhe mobilizim të resurseve lokale.



Shkrimi i projekt propozimit

Në prill, qershori, shtator dhe nëntor, ATRC-ja ka organizuar trajnim dy-ditor të titulluar “Shkrimi i projekt propozimit”. Trajnimi është përqendruar në shpjegimin e përgjithshëm të shkrimit të projekt propozimit përfshirë të gjitha elementet e një projekt propozimi. Metodologjia është bazuar në kornizën logjike dhe u ka mundësuar pjesëmarrësve zhvillimin e projekteve nga idetë fillestare në përcaktimin e objektivave, planet e zbatimit të projektit dhe buxhetit.

Qeverisja e mirë

Në maj, ATRC-ja ka trajnuar përfaqësuesit e OJQ-ve për qeverisjen e mirë. Trajnimi një-ditor ka trajtuar konceptet, strukturat dhe principet e udhëheqjes së OJQ-ve dhe sektorit jofitimprurës. Komponentët e trajnimit përfshinë standardet ndërkombëtare për OJQ-të, rolet e bordit, funksionet dhe përgjegjësitet, llogaridhënia e OJQ-ve, transparenca dhe kodi i etikës, zhvillimi i praktikave të menaxhimit demokratik, dhe sistemet menaxhuese financiare dhe administrative.

Roli i OJQ-ve në zhvillim, demokraci dhe ndërtim të shoqërisë civile

Në maj, ATRC-ja ka mbajtur trajnim një-ditor i cili ka përfshirë konceptet, strukturat dhe karakteristikat përcaktuese të shoqërisë civile dhe sektorit të OJQ-ve në shoqëritë demokratike dhe të tranzicionit. Diskutimet janë përqendruar në tiparet dhe marrëdhëniet në mes të shtetit, tregut dhe shoqërisë civile, rolet e ndryshme të OJQ-ve në zhvillimin kombëtar dhe atë global, avancimin e traditave demokratike dhe forcimin e shoqërisë civile, si dhe çështjet, trendët dhe sfidat e OJQ-ve në Ballkan.

Raportet OJQ-media

Në dhjetor, përfaqësues të OJQ-ve vendore janë trajnuar lidhur me relacionet me media. Trajnimi dy-ditor, i organizuar nga ATRC, ka përfshirë konceptet, raportet dhe perspektivat e roleve që OJQ-të dhe mediat mund të luajnë në çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë civile. Qasje të ndryshme të raporteve OJQ-media u janë shpalosur pjesëmarrësve duke i analizuar palët me interes, realizmin e mesazheve, organizimin e konferencave, shkrimin e njoftimeve për media dhe tregimeve të suksesshme.

Trajnime në bazë të kërkesave

Në vitin 2006, ATRC-ja ka kryer katër trajnime të kërkua të përfshirë planifikim strategjik, menaxhim të ekspertit, shkaktuesive të raportimit, roli i shoqërisë civile në proceset politike, dhe analiza e shpenzimeve. Shërbimet Rinore të Ferizajit, Këshillat Rinor të Rajonit të Prizrenit, dhe Qendra për Zhvillimin e Komunitetit dhe Biznesit janë OJQ-të që kanë kërkuar këto trajnime.

Punëtori trajnimi për aplikantët për grantet e ATRC KCSP-së

Në tetor dhe në dhjetor, ekipi trajnues i ATRC-së ka mbajtur dy punëtori për „Shkrim të projekt propozimit” për OJQ-të të cilat kanë qenë duke i përgatitur aplikacionet për grantet për partneritet dhe rrjetëzim të IREX-KCSP-së, runderet III dhe IV, të shpallura dhe administruara nga ATRC-ja. Gjatë këtyre trajnimeve interakteive, OJQ-të të cilat operojnë në Kosovë kanë marrë këshilla praktike dhe njoftimi për shkrimin e projekt propozimeve të tyre.



Konsultimet individuale

Në mënyrë që të sigurohet ndikim më i madh, ATRC-ja ka ofruar konsultime individuale për OJQ-të. Përfaqësuesit e OJQ-ve janë këshilluar enkas për nevojat specifike të organizatave të tyre për një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me shkrimin e projekt propozimit, zhvillimin organizativ, menaxhimin dhe sigurimin e fondeve. Gjatë 2006-ës, 110 përfaqësues të OJQ-ve kanë përfshitur nga shërbimet e këshillimit të ATRC-së.



Trajnimet dhe konsultimet individuale u janë ofruar falas OJQ-ve të Kosovës të regjistruara si OJQ klientë të ATRC-së, të cilat janë 195 OJQ.



Programi për menaxhim grantesh

Në tetor, ATRC-ja ka filluar të administroj grantet e Programit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP) të IREX-it, të financuar nga USAID, i cili ndahet në tri kategori: Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim, Grantet për Përkatje në Nivel Lokal, dhe Grantet për Fushatë Avokimi në Nivel Qendror.

OJQ-të aplikojnë për grantet e KCSP-së përmes konkurseve të hapura. Të gjitha konkurset për aplikim publikohen në mediumet e respektuara të lajmeve dhe personeli i ATRC-së dhe IREX-it organizojnë takime informative për grantet e Programit Kosovar për Shoqëri Civile.

Më 16 tetor, ATRC-ja ka shpallur konkurs për aplikim (RFA) për runden e tretë të IREX/KCSP Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim për OJQ-të e Kosovës. Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim u ndahen OJQ-ve, projekt-propozimet e të cilave përbajnë komponentë të fuqishëm partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, OJQ-ve dhe sektorëve të tjera (qeverisë lokale ose qendrore, bizneseve private). Projektet po ashtu duhet të adresojnë çështje të rëndësishme në njëren nga tri fushat e granteve: Transparencë dhe anti-korrupsioni, Zhvillimi i komunitetit ose pajtimi ndëretnik, dhe Zgjidhja e konfliktit.

Më 17 tetor, përfaqësues të IREX-it dhe ATRC-së kanë mbajtur një takim informativ në Prishtinë me OJQ-të vendore për ta prezantuar vitin e dytë të Programit të Granteve për Shoqërinë Civile të Kosovës. IREX dhe ATRC informuan përfaqësuesit e OJQ-ve për programin e viti të dytë, grantet në dispozicion për OJQ-të, procedurat e aplikimit, kriteret e përzgjedhjes, procesin e shqyrtimit dhe afatet kohore për aplikim për runden e tretë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim.

Dhjetë OJQ-ve u është ndarë donacion për rundin e tretë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim, siç vijon:

IREX/KCSP GRANT PROGRAMI	NUMRI I GRANTEVE	SHUMA
Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim, Rundi III	10	\$ 200,343.00

ORGANIZATA	PROJEKTI	RAJONI	SHUMA
Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese "BIRN"	TV emisioni "Jeta në Kosovë"	Prishtinë	\$ 24,350
Qendra e Pavarur Kulturore Informative Rinore „Elita”	Partneritet dhe rrjetëzim të OJQ-ve në Komunën e Vitisë	Gjilan	\$ 14,244
Qendra Avokuese për Progres, AVONET	Qytetarët në aksion	Ferizaj	\$ 24,989
Qendra për Arsim e Kosovës "KEC"	Arsimimi, trajnimi dhe krijimi i strukturave monitoruese në luftimin e korruptionit	Prishtinë	\$ 23,140
Qendra për Zhvillimin e Komunitetit dhe Biznesit "CBDC"	Punësimi i të Rinjve në Komunën e Gjakovës	Gjakovë	\$ 8,405
Forumi i Iniciativës Qytetare "FIQ"	Plani për komunitet më të sigurt	Prishtinë	\$ 19,150
Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve "HandiKos"	Ngritja e vetëdijes për punësim të personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal	Prishtinë	\$ 17,339
Mileniumi i Ri	Paraja publike – i takon publikut	Prishtinë	\$ 18,855
Shoqata Humanitare Bamirëse "Nëna Terezë"	Dialogu civil	Prishtinë	\$ 24,996
Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës	Dialogu social	Prishtinë	\$ 24,875

**TOTALI I GRANTEVE PËR PARTNERITET DHE RRJETIZIM,
RUNDI III**

\$ 200,343.00

Më 1 dhjetor, ATRC-ja ka shpallur konkurs për aplikim për rundin e katërt të IREX/KCSP Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim për OJQ-të e Kosovës. Procesi i ndarjes së granteve dhe implementimi i projekteve të OJQ-ve për këtë rund ka filluar në janar 2007.



Programi për informim

Programi për Informim i ATRC-së përkrah shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve të zgjedhur dhe qytetarëve përmes diskutimeve publike, mbledhjeve legjislative, konferencave, prezantimeve të donatorëve, buletinit mëjor dhe faqes së internetit të ATRC-së. Diskutimet publike, shpesh të organizuara në bashkëpunim me OJQ-të e tjera, zyret qeveritare, organizatat ndërkombëtare ose ekspertë të ndryshëm, kanë për qëllim t'i informojnë qytetarët për çështjet kyçë që ndikojnë jetën e tyre, t'i informojnë OJQ-të për iniciativat që ato mund ti ndërmarrin, të ofrojnë forum për këmbim përvojash dhe idesh, ofruar njohuri në fusha të ndryshme për OJQ-të, ofruar mundësi rrjetëzimi për OJQ-të, informuar publikun për aktivitetet e shoqërisë civile.

Në vitin 2006, ATRC-ja ka organizuar 33 diskutime, debate, tryeza dhe seminare për çështje sociale, ekonomike dhe politike me interes në Kosovë, me temat:

Dhuna ndaj gazetarëve

Në janar, ATRC, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) kanë organizuar diskutim publik për të shqyrtauar incidentet e shtuara, përfshirë dhunën, ndaj gazetarëve në Kosovë. Reagimi i policisë në raste të tillë, kushtet e punës së gazetarëve dhe presioni institucional ndaj mediave të pavarura ishin në fokus të debatit, në të cilin morën pjesë përfaqësues të mediave, OJQ-ve dhe policisë. Një material i filmuar u shfaq për pjesëmarrësit, në të cilin u prezantuan dy raste të dhunës ndaj gazetarëve.

Ligji për qasje në dokumentet zyrtare

ATRC dhe IREX (Programi Kosovar për Asistencë Mediave) kanë organizuar tryezë të rrum-bullakët në shkurt ku qeveritarë, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave u mblohdhën të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare. Panelistët kanë qenë përfaqësues të Ministrisë së Shërbimeve Publike, Arkivit Kombëtar, Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, dhe Zyrës së Ombudspersonit.

Roli i shoqërisë civile në negociatat për status

Në shkurt, ATRC-ja ka organizuar tryezë të rrumbullakët ndërmjet përfaqësuesve të OJQ-ve vendore dhe Ken Yamashitas, Drejtor i Misionit të USAID-së në Kosovë. Takimi ka pasur për qëllim të diskutoj përfshirjen e shoqërisë civile në zhvillimet me rëndësi siç janë negociatat për zgjidhjen e statusit, integrimi i minoritetave në shoqëri, luftimi i korruptionit dhe qëndrueshmëria financiare e sektorit të OJQ-ve.

Mjedis i menaxhimi i mbeturinave

ATRC-ja ka organizuar në shkurt tryezë të rrumbullakët, të kryesuar nga inxhinieri mjedisor Jim McGill, i cili është i angazhuar në fushën e mjedisit për 25 vjet në formulimin e zgjidhjeve efektive për mjedis. Tryeza, në të cilën morën pjesë përfaqësues të OJQ-ve mjedisore vendore, ka adresuar çështje dhe shqetësimë të ndjeshme që kanë të bëjnë me mjedisin në Kosovë. Diskutimi është përqendruar në zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal, përgatitjen e bizneseve për ti'u përshtatur rregulloreve mjedisore dhe të pakësojnë sasinë e mbeturinave.

Kosova dhe integrimi evropian pas zgjidhjes së statusit

Në mars, ATRC-ja ka organizuar diskutim publik në mes të Veton Surroit, lider i partisë politike ORA, dhe OJQ-ve vendore për të diskutuar integrimin e Kosovës në BE dhe nevojën për qeverisje efektive, demokracinë funksionale dhe respektimin e marrëdhënieve shumicë-pakicë. Ky ishte takimi i parë i debateve, në kuadër të iniciativës së ATRC-së për takime të përfaqësuesve të shoqërisë civile me anëtarët e ekspertit negociator.

Themelimi i Komisionit të Pavarur për Media

Përfaqësues të mediave, OJQ-ve dhe përgjegjësitë për vonesën e themelimit të Komisionit të Pavarur për Media (IMC) u mblodhën në ATRC në muajin mars për të qartësuar arsyet për këtë vonesë. Bob Gillete, Komisioneri i Përkoħshem për Media në Kosovë, dhe anëtarët e Kuvendit të Kosovës të ad-hoc grupit për IMC, Fehmi Mujota, Mahir Jagħilar dhe Gjergj Dedaj morën pjesë në këtë diskutim.

Sfidat e opozitës ndaj qeverisë dhe negociatave për statusin final të Kosovës

Përfaqësues të OJQ-ve vendore dhe Hashim Thaçi, kryetar i Partisë Demokratike dhe anëtarë i Ekspertit Negociator për statusin final të Kosovës, janë takuar në mars në ATRC për të diskutuar sfidat e partive opozitare ndaj qeverisë dhe negociatave për status.

Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Zyret e Presidentit dhe Kryeministrin

Në mars, ATRC-ja ka organizuar tryezë të rrumbullakët ndërmjet OJQ-ve vendore dhe Samet Dalipit e Jahja Llukës, këshilltarë politikë për shoqëri civile të Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës, për të themeluar mekanizma të rinj bashkëpunimi bazuar në nevojat e shoqërisë civile. Përfaqësues të OJQ-ve dhe këshilltarët politik përpiluan disa rekondime, me qëllim të krijimit të marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet sektorëve të qeverisë dhe shoqërisë civile.

Zhvillimet politike dhe ekonomike në Kosovë

Përfaqësues të OJQ-ve vendore dhe profesori Muhamet Mustafa nga Instituti Riinvest diskutuan më mars zhvillimet politike dhe ekonomike në Kosovë, gjatë një tryeze të rrumbullakët të organizuar nga ATRC-ja. Mustafa, ekspertë i ekonomisë, identifikoi fushat kryesore në të cilat shoqëria civile mund të ushtron presion: monitorim të zbatimit të ligjeve dhe luftim më aktiv të korruptionit.



A është statusi edhe çështje e grave të Kosovës?

Përfaqësues të shoqërisë civile kanë debatuar çështjen e pjesëmarrjes së grave në negociatat për statusin final të Kosovës gjatë një diskutimi publik të organizuar në mars nga ATRC-ja në bashkëpunim me Qendrën për Trajnine dhe Studime Gjinore. Roli i grave në negociata, avokimi për pjesëmarrjen e grave në këtë proces, si dhe barazia gjinore dhe legjislacioni në Kosovë janë sqaruan nga përfaqësuesit e Lobit të Grave të Kosovës dhe Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës.



Zhvillimet në procesin e decentralizimit

Në prill, Lutfi Haziri, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal njoftoi përfaqësuesit e OJQ-ve për zhvillimet në procesin e decentralizimit në Kosovë, gjatë një tryeze të rrumbullakët. Takimi, i organizuar nga ATRC, ka pasur për qëllim të diskutohet kontributi i shoqërisë civile në procesin e decentralizimit. Në shtator, ATRC-ja ka organizuar një diskutim tjetër për këtë proces në Kosovë të kryesuar nga Ministri Haziri me qëllim të informimit më të mirë të qytetarëve për zhvillimet në decentralizim.



Korrupsioni në shoqërinë civile

Shoqëria civile mund të luaj rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit në sektorin publik, mirëpo që të jetë efektive, duhet të krijoj besueshmëri publike, duke luftuar korrupsionin brenda vvetvetes. Kjo çështje është diskutuar nga përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave vendore gjatë një debati publik të organizuar në prill nga ATRC-ja dhe “Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet – Çohu”. Pjesëmarrësit diskutuan për atë se çfarë duhet bërë OJQ-të për të qenë transparente, kush duhet ta luftoj korrupsionin në shoqërinë civile, perceptimi publik për korrupsionin në shoqërinë civile, si dhe roli i donatorëve në ngritjen e transparencës së shoqërisë civile. Çohu paraqiti një draft tekst për kodin e etikës për OJQ-të, duke veçuar se ai do të përmirësonë perceptimin publik ndaj OJQ-ve.



Kosova në Evropë

Në maj, ATRC dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut kanë organizuar diskutim publik ndërmjet Stephen Heintz, kryetar i Fondacionit Vëllezërit Rockefeller dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Diskutimi është përqendruar në zhvillimet e negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës, integrimin në Bashkimin Evropian, marrëdhëniet ndëretnike, si dhe rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në përkrahjen e dialogut zyrtar.



Zhvillimet politike në Kosovë

ATRC-ja ka organizuar në maj një tryezë të rrumbullakët ndërmjet Ramush Haradinajt, kryetar i partisë politike AAK, dhe organizatave vendore joqeveritare për të diskutuar zhvillimet politike në Kosovë.

Në korrik, ATRC-ja në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Kosovës ka organizuar një tryezë tjeter të rrumbullakët për zhvillimet politike në Kosovë. Këtë radhë, përfaqësues të shoqërisë civile kanë takuar Kryetarin e Kosovës Fatmir Sejdiun për të diskutuar kontributin e shoqërisë civile ndaj zhvillimeve politike.



Plani Hapësinor i Kosovës 2005 – 2015+

Në maj, Drejtori i Institutit për Planifikim Hapësinor, Ilir Gjinolli, shqyrtoi draft dokumentin “Plani Hapësinor i Kosovës 2005 – 2015+” me përfaqësues të shoqërisë civile gjatë një tryze të organizuar nga ATRC-ja. Përmes një prezantimi vizual, Gjinolli informoi pjesëmarrësit për strategjinë e zhvillimit hapësinor të Kosovës. Instituti për Planifikim Hapësinor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përpiluar këtë draft dokument.

Në korrik, ATRC ka organizuar diskutimin e dytë me përfaqësues të OJQ-ve për “Planin Hapësinor të Kosovës 2005 – 2015+”.

Kosova sot: Këndvështrimet nga brenda dhe jashtë

Një konferencë e organizuar nga OJQ-ja sllovake Shoqata e Njerëzve në Rrezik, ATRC dhe Fondacioni Kosovar për Iniciativë Demokratike, është mbajtur në Bratislavë në muajin maj nën patronatin e Eduard Kukan, Ministër i Jashtëm i Sllovakisë. Njëzet e pesë përfaqësues të OJQ-ve të Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile sllovake, dhe ambasadorët e vendeve të ndryshme në Sllovakia, morën pjesë në këtë konferencë për të diskutuar çështjet si Integrimi Evropian, anti-korrupsioni, qëndrueshmëria financiare e OJQ-ve.

16

Programi për informim

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e vendim-marrjes

Në qershor, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, qeverisë lokale dhe asaj qendrore, dhe ekspertë diskutuan për pjesëmarrjen publike në planifikimin e zhvillimit lokal, gjatë një tryze shumëpalëshe të mbajtur në Hotel Grand, Prishtinë. Në këtë tryezë, iniciativë kjo e përbashkët e ATRC-së, UN Habitat dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyren e Kryeministrit, pjesëmarrësit identifikuani kushtet të cilat duhet të përmbushen për të përmirësuar këtë proces. Tryza është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Qytetari ligjbërës

Në korrik, Institut Demokratik i Kosovës dhe ATRC kanë organizuar tryezë të rrumbullakët për punën e Komunës së Prishtinës, në të cilën u mblodhën përfaqësues të komunës, partive politike dhe shoqërisë civile. Diskutimi është përqendruar në mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve ligjvénëse dhe ekzekutive në Komunën e Prishtinës.

Konferanca rajonale

Qeveria, shoqëria civile dhe qytetarët partnerë në qasjen strategjike të planifikimit dhe menaxhimit urban

Një konferencë rajonale për qeverisjen e mirë urbane organizuar nga ATRC, UN Habitat dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyren e Kryeministrit është mbajtur në shtator në Grand Hotel, Prishtinë. Konferanca ishte mundësi për këmbim përvojash mbi qeverisjen urbane ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera të Evropës Jug-Lindore.

Agjencia Kosovare për Antikorrupsion

Në shtator, ATRC-ja ka organizuar tryezë të rrumbullakët ndërmjet Hasan Pretenit, drejtor i Agjencisë Antikorrupsion dhe OJQ-ve vendore. Preteni i njoftoi përfaqësuesit e OJQ-ve për punën dhe aktivitetet e ardhshme të kësaj agjencie dhe diskutoi për rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në luftimin e korruptionit në Kosovë.

Platformat e partive politike: Çështjet që mund të shndërrohen në politika

Konferencë kjo e organizuar nga IREX (Programi Kosovar për Shoqëri Civile), ATRC dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) në muajin shtator. Konferenca e mbajtur në Prishtinë mblodhi partitë politike dhe organizatat joqeveritare/grupet komunitare për të filluar diskutimin dhe paraqitur idetë specifike që do të mund të qonin në krijimin e politikave konkrete partiake reflektuese të nevojave të qytetarit.

Ndikimi i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe taksave doganore në OJQ-të me status të benefacionit publik

Në tetor, përfaqësues të OJQ-ve, institucioneve qeveritare dhe agjencive ndërkombëtare diskutuan për arsyeshmërinë dhe ndikimin e heqjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksave doganore për OJQ-të me status të benefacionit publik gjatë një konference në Prishtinë. Konferenca është organizuar nga IREX dhe ATRC në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për të Drejtën e Organizatave Jo për Përfitim (ICNL).

Procesi i decentralizimit në komunën e Deçanit

Në nëntor, ATRC-ja në bashkëpunim me OJQ-në vendore “Epoka e Re” kanë organizuar diskutim publik për procesin e decentralizimit në Deçan. Pjesëmarrës ishin Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Deçanit Nazmi Selmanaj, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë nga rajoni i Deçanit.

Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë: Kujt i takon dhe i shërbën

Në dhjetor, ATRC-ja ka organizuar një tryezë të rrumbullakët për të ngritur çështjen e destinacionit të të rinjve dhe aktiviteteve sportive në Prishtinë pas mbylljes së Qendrës Rinore nga menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Përfaqësues të Departamentit për Rini të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Drejtoratit për Kulturë në Komunën e Prishtinës, Rrjetit Rinor të Kosovës, Qendrës Rinore në Prishtinë dhe OJQ-ve ishin pjesëmarrës të këtij takimi.

Të arriturat në procesin e kthimit të të zhvendosurve në Komunën e Kastriotit

Përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile diskutuan për të arriturat në procesin e kthimit të familjeve të zhvendosura në Komunën e Kastriotit gjatë një debati publik të organizuar nga ATRC-ja në dhjetor. Pjesëmarrësit shqyrtuan strategjinë për kthimin e të zhvendosurve në shtëpitë e tyre në këtë komunë, të hartuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Advocacy Training & Resource Center | Sociali Project

atrc

Advocacy Training and Resource Center

CIVIL SOCIETY TO RAISE CITIZEN AWARENESS ABOUT CULTURAL HERITAGE PROTECTION

Experts give explanations to Kenyan citizens.

Representatives of local and national government, NGOs, media and business sector in 28 municipalities of Kenya had the opportunity to gather information, make their own assessments and work together on the implementation of the business development programs, through 29 community roundtables organized by ATRC in February and March.

ATRC invites you to visit our website for more information.

ATRC News

Project Cycle Management, Vol. 14(1), 2007, ATRC Training, subject Item Management, Marketing & Communications, Project Cycle Management, Vol. 14(2), 2007, ATRC Training, subject Project Cycle Management, Roots Financial Management, Vol. 14(3), 2007, ATRC Training, subject Item Financial Management, ATRC News



Takoni donatorët

Prezantimet e donatorëve janë pjesë e programit të ATRC-së që synon njoftimin e OJQ-ve me mundësi financimi, dhe donatorët me OJQ-të të cilat kanë interesa të ngjashme.

Prezantimet e donatorëve:

Trusti Ballkanik për Demokraci

Në shkurt, ATRC ka organizuar takim ndërmjet përfaqësuesve të OJQ-ve dhe Marcel Grogan, zyrtar i programit të Trustit Ballkanik për Demokraci. Takimi ka pasur për qëllim informimin e OJQ-ve vendore përfundimtare rreth programit të Trustit Ballkanik dhe mundësitet e financimit.

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme

Në maj, koordinatori i Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme në Prishtinë, Levent Biçaku, informoi përfaqësues të OJQ-ve vendore për programet e Qendrës Palme gjatë dy prezantimeve të organizuara nga ATRC në Prishtinë dhe pjesën veriore të Mitrovicës. Biçaku prezantoi objektivat dhe prioritetet e financimit, procedurat e aplikimit, sikurse edhe fondet në dispozicion për Ballkanin Perëndimor.

Grantet e ATRC-së dhe IREX Programit Kosovar për Shoqëri Civile

Në tetor, përfaqësues të IREX-it dhe ATRC-së zhvilluan takim informativ në Prishtinë me OJQ-të për të prezantuar vitin e dytë të Programit Kosovar të Granteve për Shoqërinë Civile, financuar nga USAID. Përfaqësuesit e IREX-it dhe ATRC-së prezantuan vitin e dytë të programit, llojet e granteve në dispozicion për OJQ-të kosovare, procedurat e aplikimit, kriteret e seleksionimit, procesin e shqyrtimit dhe afatin për aplikim për rundin e tretë të granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim.

Qendra Rajonale e Mjedisit

Në tetor, përfaqësues të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Zyra në Kosovë kanë informuar përfaqësuesit e OJQ-ve vendore për shpalljen e granteve kombëtare dhe rajonale në kuadër të Sektor Programit, gjatë një prezantimi të organizuar nga ATRC. REC prezantoi objektivat e financimit, priorititet, procedurat e aplikimit dhe afatin e granteve.

Diskutimet publike të ATRC-së kanë mbledhur më shumë se 1000 përfaqësues të OJQ-ve, vendim-marrës dhe ekspertë në vitin 2006.

Kur konsideron të nevojshme, ATRC-ja ftion mediat me qëllim që informacioni i shkëmbyer në këto diskutime publike të arrij tek publiku i gjerë. Në vitin 2006, 54 artikuj gazetash janë publikuar në të përditshmet kosovare dhe 45 storie janë transmetuar në mediat elektronike për diskutimet publike të ATRC-së. Artikujt e gazetave për ATRC-në mund t'i gjeni në www.advocacy-center.org (kliko ATRC in the Media)

Buletini i ATRC-së "Avokuesi"

ATRC-ja ka vazhduar publikimin e buletinit të saj mëjor „Avokuesi” për dhe lidhur me OJQ-të e Kosovës. Ai ofron udhëzime praktike dhe informata të cilat OJQ-të vendore dhe grupet e tjera të interesuara mund t'i përdorin gjatë punës së tyre. Çdo muaj, „Avokuesi” u është dërguar në mënyrë elektronike qindra OJQ-ve, mediave, institucioneve qeveritare, agjencive ndërkombëtare dhe përkrahësve potencial në tërë Kosovën dhe jashtë saj. „Avokuesi” publikohet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe dhe gjendet në faqen e internetit të ATRC-së: www.advocacy-center.org

Faqja e internetit e ATRC-së:

www.advocacy-center.org

Faqja e internetit e ATRC-së është e përshtatshme për përdoruesit e saj dhe shërben si mjet informativ për OJQ-të brenda dhe jashtë Kosovës. Në vitin 2006, ATRC-ja ka pasur 7.588 vizitorë të faqes.

Biblioteka e ATRC-së

ATRC-ja posedon bibliotekë me më shumë se 600 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, udhëheqje, të drejtat e njeriut, mjedis, vetëdijesim gjinor, etj.

OJQ-të kosovare dhe ato ndërkombëtare, studentë universiteti, gazetarë, punonjës qeveritar dhe qytetarë të interesuar kanë qasje në bibliotekë.

Adresari i OJQ-ve

Në vitin 2006, ATRC-ja ka përditësuar adresarin e vet të OJQ-ve i cili përmban informata për 750 OJQ kosovare.





Programi për avokim

Në përpjekje për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC-ja përkrah organizatat që ndikojnë në ndryshime brenda komuniteteve, komunave të tyre, Kosovës dhe rajonit duke siguruar forum për rrjetëzim, shkëmbim informatash, dhe aktivizëm përmes Programit të saj për Avokim. Në vitin 2006, ATRC-ja është përfshirë në dy iniciativa:

Draft ligji për "Sigurimin pensional dhe invalidor"

Në qershor dhe në korrik 2006, ATRC-ja ka ndërmarrë iniciativë për t'i përfshirë rekomandimet e shoqatave dhe sindikatave të pensionistëve në draft ligjin „Sigurimi pensional dhe invalidor”, i har-tuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. ATRC ka organizuar tetë diskutime publike në shtatë qytete, ku pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e shoqatave dhe sindikatave të pensionistëve, shoqërisë civilë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës, dhe ekspertë ligjor. Diskutimet janë mbajtur në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë dhe Prishtinë. Diskutimet synonin përpilimin e rekomandimeve konkrete për këtë draft ligj me qëllim që ai të jetë sa më gjithëpërfshirës. Gjatë takimeve, përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës, Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, Shoqatës së Invalidëve të Punës, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Shoqatës së Minatorëve Pensionistë dhe Invalid të Kosovës paraqiten rekomandimet dhe vërejtjet e tyre për draft ligjin, i cili në vitin 2006 i është dorëzuar komisionit ndërministror të angazhuar në harmonizimin e propozimeve për këtë draft ligj, para se ai t'i dorëzohej qeverisë.

Koalicioni anti-korrupsion

Në dhjetor, gjashtëdhjetë përfaqësues të shoqërisë civile kanë themeluar Koalicionin Kosovar për Antikorrupsion gjatë një seminari për transparencë dhe antikorrupsion të organizuar nga ATRC-ja, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Agjencia Kosovare për Antikorrupsion. Seminari i mbajtur në Prizren synonte mbledhjen, fuqizimin dhe përkrahjen e shoqërisë civile në luftimin e korrrupsionit. Pjesëmarrësit po ashtu shqyrtuan një sërë temash që kanë të bëjnë me transparencën dhe antikorrupsionin, siç janë roli i shoqërisë civile në ngritjen e transparencës llogaridhëniës dhe kapacitetave institucionale për të luftuar korrrupsionin, rëndësia e ndërtimit të koalacioneve, avokimi si mjet në luftimin e korrrupsionit, dhe hulumtimet e fundit për perceptimet e popullit ndaj transparencës në Kosovë. Koalicioni i ri ka zgjedhur këshillin menaxhues dhe ka miratuar aktet normative.

DEKLARATA FINANCIARE



Bashkim Uka
Licensed Auditor
Bulevardi i deshmoreve 3-228
Pristine
Kosovo- UNMIK
Phone: + 377 44 222 562
Central Fax: + 381 38 249 045

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

October 19, 2007

To the ATRC Board of Directors

Rr. Agim Ramadani, 15 (2nd Floor)
Prishtina - Kosova

We have audited the financial statements and supplementary financial data of Advocacy Training and Resource Center (ATRC) expressed in EUR, for the period January – December 31, 2006. These financial statements and supplementary financial data are the responsibility of the organization's management. Our responsibility is to express an opinion on the aforementioned financial information based on our audit.

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISA). Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the reporting forms are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the reporting forms. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the proper accounting and reporting of the data on the financial statements. We believe that our audit provides a reasonable basis for our opinion.

In our opinion, the financial information present fairly, in all material respects, the financial position of ATRC as of 31December 2006, and the results of operations for the period then ended in accordance with Kosovo Accounting Standards.

Bashkim Uka
Licensed Auditor



Për periudhën janar – dhjetor 31, 2006

Bilanci Pasuror

Pasuritë	Shënim	EUR	Detyrimet	Shënim	EUR
Para të gatshme	1	42,893.16	Llogari detyrimi		
Parapagime për përfituesit e granteve	2	30,231.92	Detyrime grantesh		
Llogari arkëtimi		4,930.00	Të ardhura të mëvonshme		
Inventari			Hipotekë dhe vlerënota për pagesë		
Investimet			Detyrime të tjera		
Të sigurta			Detyrime gjithsej		0
Të tjera					
Toka, ndërtesa dhe pajisje	3	14,957.99			
Automjetet	3	9,541.93			
Pasuri të tjera		1,739.13			
Ukupna imovina:		104,294.13	Bilanci i fondevë		
			Bilanci i fondevë më 1 janar 2006	4	49,067.54
			Teprica (nga llogaria e fitimit dhe të ardhurave)		55,226.59
			Bilanci gjithsej		104,294.13
			Detyrimet dhe bilanci i fondevë gjithsej:		104,294.13

Llogaria e fitimit dhe e të ardhurave

Të hyrat	Shënim	EUR	Shpenzimet	Shënim	EUR
Kontributet, dhuratat ose grantet	4	258,746.48	Shërbimet e programit	5	142,212.34
Pagesat dhe të hyrat nga veprimtaritë	4	11,829.26	Menaxhmenti dhe administrata		
Të pritshme për pagim			Shpenzime të tjera		
Pjesë fitimi dhe interesat					
Qira					
Të ardhura të tjera nga investimi			Shpenzimet gjithsej:		215,349.15
Shitje e pasurive					
(minus koston e shitjeve)					
Të hyra nga ngjarjet speciale			Të ardhurat neto nga operacionet:		55,226.59
Shitjet me shumicë të inventarit					
Të hyra të tjera					
Të hyrat gjithsej:		270,575.74	Taksa		
			Të ardhurat neto:		55,226.59

ANTARËT E BORDIT TË ATRC-së

Ilaz Ramajli

Avokat; Ramajli dhe Partnerët

Anton Berishaj

Profesor; Universiti i Prishtinës

Sejdi Osmani

Drejtëor administrativ; RIINVEST

Igballe Rogova

Drejtoreshë ekzekutive; Rrjeti i Grave të Kosovës¹

Petrit Selimi

Drejtëor ekzekutiv; KUMT Consulting

STAFI I ATRC-së

Menaxhere financiare e granteve

Safeta Xhekoviq

safeta@advocacy-center.org

Menaxher financiar dhe administrativ

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere financiare e granteve

Arjeta Doroci

arjeta@advocacy-center.org

Menaxhere e trajnimeve dhe konsulencave

Donika Podrimja-Salihu

donika@advocacy-center.org

Trajnere dhe konsultante

Afërdita Surroi

aferdita@advocacy-center.org

Trajnere dhe konsultant

Kushtrim Islami

kushtrim@advocacy-center.org

Trajnere dhe konsultante

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Menaxhere e granteve

Teuta Luzha

teuta@advocacy-center.org

Zyrtar për grante

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Zyrtar për grante

Xhafer Ahmeti

xhafer@advocacy-center.org

Zyrtare për grante

Natyra Zhjeqi

natyra@advocacy-center.org

Menaxhere komunikimi dhe punë me jashtë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Menaxher për teknologji informative dhe databaza

Gëzim Kunoviku

gëzim@advocacy-center.org

Ekipi i projektit për monitorim të të kthyerë

Emine Emini

emine@advocacy-center.org

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

KONTAKT INFORMATAT

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org

Lokacioni i ATRC-së: ATRC-ja ndodhet afër

qendrës së Prishtinës në këtë adresë:

Rr. Agim Ramadani, nr. 15, katë i 2-të,
Prishtinë, Kosovë

¹ Deri në gusht 2006



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Ky raport është mundësuar financiarisht me përkrahjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Bordit për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX) në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për Programin Kosovar për Shoqëri Civile. Përbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk pasqyron detyrimisht qëndrimet e USAID-së ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2006, ATRC – Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Prishtinë - Kosovë
ATRC Raporti Vjetor 2006 përgatitur nga ATRC; disenji: Besfort Mehmeti



Centar za Obuku i Resurse u Zastupanju
GODIŠNJI IZVEŠTAJ 2006



Sadržaj

PISMO IZVRŠNOG DIREKTORA	3
UVOD	4
Misija	4
O ATRC-u	4
Podržavaoci	5
Partneri	6
O ovom izveštaju	6
OBUKA, KONSULTACIJE & PROGRAM NADGRADNJE KAPACITETA	7
PROGRAM DAVANJA GRANTOVA	10
INFORMACIJSKI PROGRAM	12
Događaji Javnih Dialoga	
ATRC Bilten "Zastupnik"	
ATRC Web stranica	
ATRC BIBLIOTEKA	
ATRC DIREKTORIJUM NVO-a	
PROGRAM ZASTUPANJA	20
FINANCIJSKI IZVEŠTAJI	21
ČLANOVI ODBORA	23
PERSONAL I KONTAKT INFORMACIJE	23
ATRC Lokacija	23

PISMO IZVRŠNOG DIREKTORA

Godina 2006 bila je godina velikih očekivanja na Kosovu. To je bila godina kada je Tim jedinstva Kosova intenzivirao pregovore sa Beogradom, kojima je posredovao Predsednik Ahtisari. Bila je to godina kada su Kosovari odlučili da odlože lokalne izbore kako oni ne bi uticali na pregovarački proces. Bila je to godina velikih nadanja i očekivanja da se pronađe kompromisno rešenje za konačni status Kosova. Bila je to godina kada je Ahtisarijev predlog, posebno oni članovi koji se odnose na decentralizaciju i formiranje novih opština sa srpskom većinom, bio predmet intenzivnih medijskih špekulacija i, uopšte, naših života.

Šta je ovo značilo za rad ATRC-a?

ATRC je postao mesto gde su članovi Tima jedinstva Kosova dolazili i obraćali se NVO-ma, interesnim grupama i građanima Kosova. Među našim najuglednijim govornicima bili su g. Fatmir Sejdju, Predsednik Kosova, g. Ljufti Haziri, Potpredsednik Vlade i lideri opozicionih partija, g. Hašim Tači i g. Veton Suroi. ATRC je obezbedio 21 obuku za 525 predstavnika NVO-a. ATRC je organizovao 33 javne debate kojima je prisustvovalo više od hiljadu učesnika iz svih delova Kosova. ATRC je, takođe, rukovodio grantovima za NVO-e i još više unapredio svoje usluge NVO sektoru poboljšavši širenje informacija i druge kanale komunikacije.


Ponosni smo na konstruktivnu ulogu koju smo imali tokom godine, služeći kao centar za pružanje svih usluga u oblasti obuke i resursa za zajednicu nevladinih organizacija. Obezbedili smo NVO-ma resurse kako bi ojačali njihove organizacione, upravljačke i zastupničke kapacitete i povećali ulogu tog sektora u socijalnom, ekonomskom i političkom razvoju. Naročito smo ponosni zato što smo uspostavili dobre odnose sa manjinskim NVO-ma; posebno onim u severnom delu Kosova.

